



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

MBI NDARJEN E VEPRIMTARIVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDIT TË PENSIONIT VULLNETAR

Miratuar me Vendim Bordi nr.24, datë 23.02.2011

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton kriteret dhe standardet për ndarjen e veprimtarisë së administrimit të fondit të pensionit, nga veprimtaria e administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, në rastin kur të dy veprimtaritë kryhen nga e njëjta shoqëri administrative e licencuar.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të dispozitave të nenit 23, paragrafi 4 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensioneve vullnetare”, këtu e më poshtë (“Ligji”).

Neni 3

Investimet e lejuara

1. Shoqëria adminstruese mund të investojë asetet e fondit të pensionit në kuota/ aksione të sipërmarrje të investimeve kolektive të administruara prej saj si mëposhtë:

- a) shoqëria adminstruese nuk mund të investojë më shumë se 10% të aseteve të fondit të pensionit në total në kuota/aksione të sipërmarrjeve të tjera të administruara prej saj;
- b) në rast të investimit të aseteve të fondit të pensionit në kuota/aksione të sipërmarrjeve të tjera të administruara nga shoqëria adminstruese, kjo e fundit nuk mund t’i ngarkojë tarifa administrimi fondit të pensionit;

- c) shoqëria adminstruese është e detyruar të njoftojë anëtarët e fondit të pensionit në lidhje me masën e aseteve të llogarisë së tij të pensionit të investuara në sipërmarrje të investimeve kolektive të administruara nga ajo.

Neni 4

Ndarja e aseteve

1. Asetet e fondit të pensionit të mbajtura me një depozitar, duhet të jenë qartësisht të dallueshme nga asetet e tjera të mbajtura nga depozitari për llogari të shoqërisë adminstruese.
2. Shoqëria adminstruese duhet të nënshkruajë kontrata të vecanta me depozitarin për shërbimet e këtij të fundit sipas legjislacionit, në lidhje me fondet e pensionit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive që ajo administron.

Neni 5

Mbajtja e llogarive të vecanta

Shoqëria adminstruese është e detyruar të pasqyrojë çdo element të veprimtarisë të administrimit të fondit të pensionit në regjistrime dhe llogari të veçanta dhe tërësisht të ndara nga veprimtaria e administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Neni 6

Mbajtja e njësive operative të veçanta

1. Shoqëria adminstruese është e detyruar të mbajë njësi operative të veçanta të zyrës kryesore për aktivitetin e administrimit të fondit të pensionit dhe atë të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Zyra kryesore është ajo që ka si funksion administrimin e aseteve të fondit të pensioneve, organizimin e transaksioneve me letra me vlere, dhe kryerjen e analizave për tregjet e kapitalit.
2. Detyrimi i shoqërisë adminstruese është të prodhojë, zbatojë dhe përditësojë rregullisht dokumentet e brendshme të cilat rregullojnë procedurat në lidhje me:
 - a) organizimin fizik të kësaj njësie (përcaktim autoriteti, përgjegjësie dhe ndarje aktivitetesh);
 - b) rrjedhën e lëvizjes së dokumenteve dhe arkivimin;
 - c) përpunimin e transaksioneve (vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së transaksioneve, si dhe udhëzime specifike për rregullimin e metodologjisë së punës për çdo instrument investimi, ekzekutimin e transaksioneve në një bursë të huaj, transaksioneve me depozitat dhe transaksionet me letra me vlerë);
 - ç) konfirmimin (deklarimin) dhe korrigjimin e gabimeve;
 - d) raportimin ditor dhe harmonizimin e ekuilibrave në këtë njësi operative.

Neni 7

Dispozita të fundit

1. Shoqëria adminstruese duhet të hartojë një rregullore të brendshme për të garantuar respektimin e kërkesave të parashikuara në këtë rregullore, dhe e paraqet atë në Autoritet.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Elisabeta GJONI